Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut
Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

MENDIM

Data e miratimit: 22 gusht 2012

Lënda nr. 34/08

Desanka STANISHIÇ dhe Zoran STANISHIÇ

kundër

UNMIK-ut

Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, i mbledhur më 22 gusht 2012, me anëtarët vijues të pranishëm:

Z. Paul LEMMENS, Kryetar
Znj. Christine CHINKIN

Të ndihmuar nga
Z. Andrey ANTONOV, Zyrtar ekzekutiv

Pas shqyrtimit të ankesës së sipërpërmendur, të paraqitur në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 të datës 23 mars 2006 për themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut,

Pas evidentimit të tërheqjes së z. Marek Nowicki nga rasti, në pajtim me Rregullën 12 të Rregullores së punës së Panelit,

Pas diskutimeve, jep konstatimet dhe rekomandimet vijuese:

I. PROCEDURA PRANË PANELIT

1. Ankesa u paraqit më 21 gusht 2008 dhe u regjistrua më 17 shtator 2008.

2. Me vendimin e 10 qershorit 2012, Paneli e shpalli ankesën të pranueshme pjesërisht.

3. Më 20 korrik 2012, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) i paraqiti komentet e UNMIK-ut për bazueshmërinë e ankesës.

II. FAKTET

4. Ankuesit janë ish banorë të Kosovës të cilët aktualisht jetojnë në territorin e Serbisë. Ankuesit janë pronarë të pasurisë së paluajtshme në Kosovë, një shtëpi dhe një ndërtesë në të cilën është akomoduar një kompani komerciale në pronësi të z. Stanishiç, "Sigma Commerce".

5. Në fund të qershorit 1999, z. Stanishiç shkoi në Serbi, për shkaqe sigurie. Znj. Stanishiç qëndroi në shtëpi. Pas largimit të z. Stanishiç, lokalet komerciale pohohet se janë uzurpuar në mënyrë ilegale nga persona të njohur për ankuesit. Dikur më vonë, znj. Stanishiç pohohet se është mbajtur në arrest në mënyrë të paligjshme nga personat e njëjtë, ishte kërcënuar, dhe me gjasë ishte detyruar të largohet nga Kosova.

6. Më 15 korrik 2004, znj. Stanishiç parashtroi kërkesë për kompensim të dëmit të shkaktuar shtëpisë së saj dhe objektit komercial pas hyrjes së KFOR-it në Kosovë, shpejt pas 15 korrikut 1999. Kërkesa u parashtrua pranë gjykatës komunale në Prishtinë, kundër komunës së Prishtinës dhe Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë (IPVQ). Znj. Stanishiç kërkoi një shumë prej 295,000 eurosh.

7. Përafërsisht 17,000 kërkesa për kompensim u parashtruan në vitin 2004 pranë gjykatave të Kosovës, numri më i madh i të cilave nga serbët e Kosovës, të cilët për shkak të luftës i kishin braktisur shtëpitë e tyre në Kosovë në vitin 1999, dhe prona e të cilëve më vonë ishte dëmtuar apo shkatërruar. Me synimin për të përmbushur afatin kohor prej pesë vitesh për paraqitjen e kërkesave civile për kompensim, këta ankues i kanë parashtruar kërkesat e tyre rreth kohës së njëjtë në vitin 2004. Këto kërkesa/ankesa të tyre ishin drejtuar kundër UNMIK-ut, KFOR-it, IPVQ-ve dhe komunës përkatëse (shih Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (HRAP), *Milogoriç dhe të Tjerët*, lëndët me nr. 38/08, 58/08, 61/08, 63/08 dhe 69/08, mendim i 24 marsit 2010, në § 1; për bazën ligjore në të cilën ankuesit e bazuan kërkesën/ankesën e tyre shih mendimin e njëjtë, në § 5).

8. Sa u përket këtyre rasteve, drejtori i Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut (DD) u dërgoi një shkresë të gjithë kryetarëve të gjykatave komunale dhe atyre të qarkut dhe kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës më 26 gusht 2004. Në këtë shkresë, drejtori i DD theksoi se ishin parashtruar "mbi 14,000" kërkesa të tilla. Ai iu referua "problemit që do ta shkaktonte një fluks kaq i madh i kërkesave për gjykatat", dhe kërkoi që "asnjë rast [i tillë] të mos caktohej për shqyrtim derisa bashkërisht të vendosej se si më së miri të procedohej me këto lëndë" (për tekstin e plotë të shkresës, shih mendimin për *Milogoriç dhe të Tjerët*, cituar në § 7 lart, në § 6).

9. Nga korriku 1999 deri më qershor 2005, shtëpia dhe lokalet komerciale ishin shfrytëzuar nga persona të tjerë. Dëbimi i tyre u bë në qershor të vitit 2005, i organizuar nga Drejtoria për çështje banesore pronësore.

10. Më 10 nëntor 2005, ankuesit u kthyen në pronën e tyre, të cilën e gjetën shumë të dëmtuar dhe të plaçkitur. Ata qëndruan aty për rreth gjashtë muaj, periudhë gjatë së cilës ata e pastruan shtëpinë dhe i rregulluan gjërat e nevojshme elementare. Sipas ankuesve, lokalet e Sigma commerce ishin në gjendje të mjerueshme dhe ata vlerësuan shpenzimet për riparimet e nevojshme të jenë përafërsisht 100,000 euro. Riparimet nuk u bënë, dhe ankuesit me gjasë u larguan nga këto lokale sërish.

11. Në ndërkohë, më 15 nëntor 2005, DD u bëri thirrje gjykatave të fillojnë me procedimin e kërkesave për kompensim të dëmit të shkaktuar nga persona të identifikuar fizikë dhe për dëmet e shkaktuara pas tetorit 2000, duke konsideruar se "pengesat për procedim efikas të këtyre rasteve" më nuk ekzistonin. Kërkesat/ankesat që kishin të bënin me ngjarjet e paraqitura para tetorit 2000 nuk ndikoheshin nga kjo shkresë.

12. Edhe pse rasti i ankuesve nuk ishte plotësisht në kategorinë e rasteve të cilave iu referua DD, gjykata komunale e Prishtinës filloi me procedimin e kërkesës/ankesës së ankuesve.

13. Seancat dëgjimore u mbajtën më 14 korrik dhe 18 shtator 2006. Gjatë procedurës kërkesa u modifikua, ashtu që të ndërlidhet me dëmin e shkaktuar në objektin komercial në qershor 2005 nga uzurpuesi i paligjshëm, kur ai duhej ta lironte atë. Z. Stanishiç u paraqit si ankues shtesë dhe UNMIK-u dhe KFOR-i ishin caktuar si të paditur shtesë.

14. Më 23 nëntor 2006, gjykata komunale e Prishtinës gjeti se UNMIK-u gëzonte imunitet nga juridiksioni vendor, dhe ankesën kundër UNMIK-ut e shpalli të papranueshme.

15. Më 19 dhjetor 2006, ankuesit parashtruan ankesë kundër këtij aktgjykimi në gjykatën e qarkut të Prishtinës.

16. Meqenëse ankesa ishte drejtuar kundër komunës së Prishtinës dhe IPVQ-ve, rasti mbeti në pritje për shqyrtim pranë gjykatës komunale të Prishtinës. Një seancë tjetër dëgjimore u mbajt më 15 janar 2007. Më 22 janar 2007, gjykata komunale e Prishtinës konstatoi se të dy të padituri nuk kishin "legjitimitet pasiv", dhe ankesën kundër tyre e shpalli të papranueshme.

17. Më 13 shkurt 2007, ankuesit parashtruan ankesë kundër këtij aktgjykimi në gjykatën e qarkut në Prishtinë. Sipas ankuesve, dosja ishte bartur në gjykatën e qarkut më 25 qershor 2007.

18. Duke vendosur për këtë ankesë, gjykata e qarkut më 11 shtator 2008 e ktheu mbrapsht aktgjykimin e gjykatës komunale të datës 22 janar 2007, dhe rastin ia dërgoi gjykatës për rishqyrtim. Gjykata e qarkut konsideroi se çështja e mundësisë për t'u paditur ishte çështje që lidhej me bazueshmërinë e ankesës dhe jo me pranueshmërinë e saj. Gjykata e qarkut në mënyrë të qartë e ka udhëzuar gjykatën komunale të ftojë ankuesit që ata të specifikojnë palët e paditura dhe pastaj të vendoset rasti për bazueshmërinë e tij. Duket se ky aktgjykim i 11 shtatorit 2008 e kishte edhe efektin e hedhjes së ankesës kundër aktgjykimit të gjykatë komunale të datës 23 nëntor 2006, duke e sjell kështu tërë kontestin pranë gjykatës komunale.

19. Në procedurën e kthimit të rasatit në gjykatën komunale të Prishtinës, ankuesit theksuan se palët e paditura janë komuna e Prishtinës, Qeveria e Kosovës dhe UNMIK-u.

20. Më 28 shtator 2008, drejtori i DD i këshilloi gjykatat që rastet të cilat nuk ishin caktuar për shqyrtim bazuar në kërkesën e 26 gushtit të vitit 2004 (shih § 8 lart) tani të procedoheshin.

21. Më 9 dhjetor 2008, përgjegjësia e UNMIK-ut lidhur me gjyqësorin në Kosovë përfundoi me marrjen e kontrollit të plotë operacional nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) në fushën e sundimit të ligjit, pas deklaratës së bërë nga Kryetari i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara më 26 nëntor 2008 (S/PRST/2008/44), duke përshëndetur angazhimin e vazhdueshëm të Bashkimit Evropian në Kosovë.

22. Më 12 janar 2009, gjykata komunale konstatoi se komuna e Prishtinës dhe Qeveria e Kosovës nuk kishin "legjitimitet pasiv", dhe e shpallën ankesën të pabazuar në këtë aspekt. Sa i përket ankesës drejtuar kundër UNMIK-ut, gjykata konstatoi se nuk ka juridiksion, për shkak të imunitetit të UNMIK-ut nga proceset ligjore në gjykatat vendore.

23. Ankuesit parashtruan ankesë kundër këtij aktgjykimi në gjykatën e qarkut të Prishtinës. Më 18 nëntor 2010, gjykata e qarkut e hodhi poshtë ankesën dhe e mbështeti vendimin e lartcekur të gjykatës komunale.

24. Më 10 janar 2011, ankuesit parashtruan kërkesë për rishqyrtim në Gjykatën Supreme. Më 27 korrik 2012, Paneli u informua nga Gjykata Supreme se rasti i ankuesve akoma ishte në pritje për shqyrtim.

III. ANKESA

25. Përderisa ankesa është shpallur e pranueshme, ankuesit në esencë pohojnë se procedura lidhur me kërkesën e tyre për kompensim për pronën e shkatërruar, nuk është zbatuar brenda një kohe të arsyeshme, duke shkelur nenin 6 § 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

IV. LIGJI

A. Parashtresat e palëve

Parashtresat e palëve

26. Ankuesit u referohen vonesave të ndryshme në procedurën pranë gjykatës komunale të Prishtinës, gjykatës së qarkut në Prishtinë dhe Gjykatës Supreme, në procedurën lidhur me ankesën e tyre kundër komunës së Prishtinës, IPVQ-ve dhe UNMIK-ut.

27. Në këtë aspekt, siç është theksuar lart, ata thirren në shkelje të së drejtës së tyre për të marrë një vendim brenda një kohe të arsyeshme, të garantuar me nenin 6 § 1 të KEDNJ.

Parashtresat e UNMIK-ut

28. Në komentet e tij për bazueshmërinë e ankesës, PSSP-ja pranon se sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, vlerësimi i vonesave në procedura gjyqësore duhet të bazohet në afatin kohor ndërmjet paraqitjes së ankesës dhe momentin kur aktgjykimi vendor merr formën e prerë.

29. PSSP-ja po ashtu pranon se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës duhet vlerësuar duke marrë parasysh rrethanat specifike të rastit, *d.m.th*. sjelljen e autoriteteve gjyqësore, ndërlikueshmërinë e rastit dhe sjelljen e ankuesve.

30. PSSP-ja po ashtu pranon se detyrimi për të organizuar sistemet gjyqësore në atë mënyrë ku gjykatat të mund të përmbushin çdo kusht të nenit 6 të KEDNJ, duke përfshirë edhe obligimin për të dëgjuar rastet brenda një kohe të arsyeshme, është e autoriteteve publike. Një grumbullim i përkohshëm i lëndëve nuk nënkupton përgjegjësi, me kusht që autoritetet të ndërmarrin veprime të menjëhershme korrigjuese të arsyeshme për trajtimin e situatës së jashtëzakonshme.

31. Përveç kësaj, PSSP-ja thekson se gjatë vlerësimit nëse kohëzgjatja e procedurës mund të konsiderohet e arsyeshme, duhet marrë parasysh ndërlikueshmërinë e rastit. Ndërlikueshmëria e tillë mund të përfshijë çështje faktike dhe juridike, dhe mund të lehtësojë përgjegjësinë e autoriteteve relevante në menaxhimin e rastit brenda një afati të caktuar kohor.

32. PSSP-ja thekson se në rastin e ankuesve, afati kohor për vlerësimin e çfarëdo vonese në procedurën gjyqësore është nga data e paraqitjes së ankesës në gjykatën komunale të Prishtinës në korrik 2004, deri në kohën kur UNMIK-u ia dorëzoi EULEX-it përgjegjësitë e mbetura në fushën e drejtësisë, 9 dhjetor 2008. PSSP-ja thekson se brenda kësaj periudhe kohore institucionet gjyqësore të Kosovës e kanë shqyrtuar tri herë lëndën, përkatësisht në nëntor 2006, janar 2007 dhe shtator 2008, dhe se rasti aktualisht është në pritje për shqyrtim nga Gjykata Supreme. Sipas PSSP-së, argumenti i ankuesve se ankesa e tyre nuk është trajtuar brenda një kohe të arsyeshme është e pabazuar.

33. PSSP-ja thekson se kërkesa/ankesa e ankuesve ka një natyrë komplekse. Megjithatë, përkundër kompleksitetit, çështja është gjykuar nga gjykatat përkatëse me kohë dhe në mënyrën e duhur.

34. PSSP-ja konkludon se nuk ka shkelje të së drejtës së ankuesve për vendim gjyqësor brenda një kohe të arsyeshme, meqë lënda është trajtuar nga autoritetet gjyqësore të Kosovës pa vonesa të paarsyeshme gjatë periudhës nga korriku 2004 deri në dhjetor 2008.

B. Vlerësim i Panelit

1. Parimet e përgjithshme

35. Në pjesën përkatëse të nenit 6 § 1 të KEDNJ thuhet,

> "Në përcaktimin e të drejtave civile dhe obligimeve ..., çdokush ka të drejtë në dëgjim të drejtë brenda një kohe të arsyeshme nga [një] ... tribunal ..."

36. Paneli përkujton se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës duhet të vlerësohet duke marrë parasysh rrethanat e rastit dhe duke iu referuar kritereve vijuese: kompleksitetit të rastit, sjelljes së ankuesit dhe autoriteteve relevante dhe në çfarë aspekti është rrezikuar ankuesi në këtë kontest (shih, në mesin e shumë autoriteteve të tjera, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) (Grand Chamber), *Frydlender kundër Francës*, nr. 30979/96, aktgjykim i 27 qershorit 2000, *KEDNJ*, 2000-VII, § 43; shih gjithashtu Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat

e Njeriut (PKDNJ), *Emini*, nr. 17/08, mendim i 18 qershorit 2010, § 21; PKDNJ, *Mitroviç*, nr. 05/07, mendim i 17 dhjetorit 2010, § 85).

37. Gjithashtu, Paneli përkujton se KEDNJ i obligon shtetet të organizojnë sistemet e tyre ligjore ashtu që gjykatave t'u mundësojnë të përmbushin kushtet e nenit 6 § 1, duke përfshirë edhe kushtin e gjykimit brenda "një kohe të arsyeshme". Përderisa një grumbullim i përkohshëm i punës së gjykatave nuk nënkupton se është përgjegjësi e autoriteteve nëse ata ndërmarrin veprime të duhura për rregullimin e situatës me shpejtësinë e nevojshme, një ngarkesë e vazhdueshme me lëndë nuk mund të arsyetojë një kohëzgjatje të tepruar të procedurës (shih GJEDNJ, *Pammel kundër Gjermanisë* dhe *Probstmeier kundër Gjermanisë*, aktgjykim i 1 korrikut 1997, *Raportet e aktgjykimeve dhe vendimeve*, 1997-IV, f. 1112, § 69 viz. f. 1138, § 64).

2. Zbatimi i parimeve të përgjithshme në rastin aktual

a. Periudha që duhet marrë parasysh

38. Ankesa e ankuesit u regjistrua nga gjykata komunale e Prishtinës më 15 korrik 2004. Kjo datë shënon hapjen e procedurës. Mirëpo, periudha që duhet marrë parasysh fillon nga data e juridiksionit kohor të Panelit, që është 23 prilli 2005. Gjatë vlerësimit të arsyeshmërisë së kohës që ka kaluar pas 23 prillit 2005, Paneli megjithatë do të merr parasysh gjendjen e procedurës në atë moment (GJEDNJ, *Foti dhe të Tjerët kundër Italisë*, aktgjykim i 10 dhjetorit 1982, *Publikime të Gjykatës*, Seria A, nr. 56, f. 15, § 53; GJEDNJ, *Styranowski kundër Polonisë*, aktgjykim i 30 tetorit 1998, *Raportet e aktgjykimeve dhe vendimeve*, 1998-VIII, f. 3376, § 46).

39. Ankesa/kërkesa e ankuesve akoma është në pritje. Mirëpo, siç u theksua më lart, më 9 dhjetor 2008, përgjegjësia e UNMIK-ut sa i përket gjyqësorit në Kosovë përfundoi (shih § 21). Prandaj, periudha që është duke u shqyrtuar përfundoi më 9 dhjetor 2008. Sa i përket periudhës nga 9 dhjetori 2008, Paneli nuk mund të shqyrtojë nëse kohëzgjatja e procedurës ishte në përputhje me kushtin e kohës së arsyeshme.

40. Kohëzgjatja e përgjithshme e procedurës, deri në momentin kur UNMIK-u më nuk ishte përgjegjës, ishte katër vite, katër muaj dhe njëzet e katër ditë, nga të cilat tri vite, shtatë muaj dhe gjashtëmbëdhjetë ditë duhet të shqyrtohen nga Paneli. Gjatë periudhës nën shqyrtim, lënda ishte në pritje pranë gjykatës komunale të Prishtinës, gjykatës së qarkut në Prishtinë dhe sërish pranë gjykatës komunale.

b. Vlerësimi i arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës

41. Sa i përket ndërlikueshmërisë së rastit, Paneli thekson se ankesa/kërkesa e ankuesve ishte njëra nga rreth 17,000 ankesa/kërkesa të ngjashme, të cilat gjithë së bashku krijuan probleme logjistike dhe probleme të tjera për gjykatat e Kosovës. Të gjitha këto kërkesa/ankesa ngritën çështjen e vështirë të imunitetit të UNMIK-ut nga juridiksioni i gjykatave vendore, si dhe nga zbatimi i ligjit përmes të cilit autoritetet publike ishin përgjegjëse për vepra të caktuara të kryera nga keqbërës të panjohur. Paneli pranon se për shkak të karakteristikave specifike të këtyre ankesave/kërkesave, rasti i ankuesve paraqiste ndërlikime të caktuara.

42. Sa i përket sjelljes së ankuesve, nga informacionet në dosjen e rastit apo nga parashtresat e PSSP-së, nuk shihet se ankuesit ishin përgjegjës për ndonjë vonesë të procedurës.

43. Sa i përket sjelljes së autoriteteve, Paneli thekson se historiku i lëndës pranë gjykatës komunale dhe gjykatës së qarkut të Prishtinës mund të ndahet në katër periudha të ndryshme: periudha e parë nga paraqitja e ankesës/kërkesës pranë gjykatës komunale të datës 15 korrik 2004 deri në shkresën e DD të datës 15 nëntor 2005; periudha e dytë nga shkresa e sipërpërmendur deri në aktgjykimin e (dytë) të gjykatës komunale, të marrë më 22 janar 2007; periudha e tretë nga paraqitja e ankesës në gjykatën e qarkut kundër aktgjykimit, deri në aktgjykimin e gjykatës së qarkut, të marrë më 11 shtator 2008; periudha e katërt, nga referimi i rastit gjykatës komunale me aktgjykimin e përmendur të gjykatës së qarkut deri në aktgjykimin e (tretë) të gjykatës komunale, të marrë më 12 janar 2009. Fazat tjera të procedurës nuk duhet shqyrtuar meqë ata përfshihen në një periudhë kur UNMIK-u më nuk ishte përgjegjës.

44. Sa i përket periudhës së parë, kjo është periudhë kur nuk është ndërmarrë asnjë veprim nga gjykata komunale e Prishtinës. Një vit e katër muaj kaluan ndërmjet pranimit të dosjes së rastit nga gjykata komunale (më 15 korrik 2004), dhe shkresës së DD të datës 15 nëntor 2005. Mirëpo, vetëm gjashtë muaj dhe 22 ditë kaluan nga 23 prilli 2005, datë nga e cila Paneli ka juridiksion. Derisa vonesa gjatë periudhës së parë nuk është e arsyetuar mjaftueshëm, përfshin vetëm një periudhë relativisht të shkurtër të tërë periudhës që është nën shqyrtim.

45. Sa i përket periudhës së dytë, Paneli thekson se nuk ka pasur vonesa të shprehura. U mbajtën dy seanca dëgjimore, dhe gjykata komunale mori dy aktgjykime (më 23 nëntor 2006 dhe 22 janar 2007).

46. Sa i përket periudhës së tretë, Paneli konsideron se derisa gjykata e qarkut ishte e ngadalshme me fillimin e udhëzimeve për rastin, ajo megjithatë mori aktgjykim më 11 shtator 2008. Prandaj, Paneli nuk konsideron se procedura zgjati pa arsye shumë gjatë.

47. Më në fund, lidhur me periudhën e katërt, Paneli thekson se gjykata komunale aty për aty organizoi seancë dëgjimore dhe vendosi për rastin më 12 janar 2009, që është pak më shumë se tre muaj pasi rasti ju kishte kthyer kësaj gjykate. Periudha që është duke u shqyrtuar nga Paneli, përfundoi më 9 dhjetor 2008, kështu që nuk pati vonesa të paarsyeshme.

48. Sa i përket asaj se si u dëmtuan ankuesit, Paneli pranon se rasti ishte i një rëndësie të madhe për ata. Ata që të dy duhej të largoheshin nga Kosova duke u frikësuar për jetën e tyre, duke lënë pas pronën dhe pasurinë e tyre. Nëse do ta fitonin rastin e tyre, ata do të pranonin një shumë të konsiderueshme si kompensim.

c. **Konkludim**

49. Procedurat në rastin aktual, në periudhën ndërmjet 23 prillit 2005 dhe 9 dhjetor 2008, u karakterizuan me aktivitete të pamohueshme të gjykatave, duke rezultuar me tri aktgjykime të njëpasnjëshme. Duke marrë parasysh të gjitha elementet relevante, dhe pavarësisht nga fakti se kishte disa vonesa me të cilat ngarkohej UNMIK-u për të cilat nuk mund të jepej arsyetim i mjaftueshëm dhe pavarësisht

se si u dëmtuan ankuesit, Paneli nuk mund të konkludojë se kohëzgjatja e procedurës gjatë periudhës së sipërpërmendur ishte e tepruar apo se procedura nuk përmbushi kushtin e kohës së arsyeshme.

50. Prandaj, nuk ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNJ.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli unanimisht,

KONSTATON SE NUK KA PASUR SHKELJE TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT.

Andrey ANTONOV
Zyrtar ekzekutiv

Paul LEMMENS
Kryetar